



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

A.K.A.F.P.K.
Nr. 202/10 prot.
Datë: 17.02.2023

Nr. 22386/prot.
16

Data: 18, 02, 2023

VENDIM

Nr. 9, Datë 18, 02, 2023

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; në urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e ofruesit të AFP-së, me të dhëna si më poshtë:

1. **Emri i ofruesit të AFP-së:** Qendër Multifunkionale New Generation, Tiranë
2. **Akti zyrtar i themelimit/licencimit:** Licencë lëshuar më datë 2014-05-08 nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Licencë lëshuar më datë 2022-02-03 nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Shkresë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 2048 prot., datë 3.2.2022, me lëndë: "Miratim kërkesës për licencim", drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit, Shkresë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 6337/2 prot., datë 20.4.2021, me lëndë: "Miratim kërkesës për licencim", drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit, Shkresë me nr. 22215/2 prot, datë 20.1.2021 e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; me lëndë: "Miratim kërkesës për ndryshim adrese" drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit.
3. **Organizimi i institucionit:** Qendër shumëfunktionale private e AFP-së
4. **Lloji i ofruesit të AFP-së:** Qendër shumëfunktionale e AFP-së
5. **Nipti:** J61814029N

Pasi mora në shqyrtim dokumentacionin e vetëvlerësimit, raportin e vetëvlerësimit, dokumentacionin e vlerësimit të jashtëm, raportin e vlerësimit të jashtëm për akreditim, si dhe të gjithë procedurën e akreditimit të zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK),
konstatoj se:

- a. procedura dhe procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditim janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara nga AKAFPK-ja për këtë proces;
- b. vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në dokumentacionin e vetëvlerësimit, vlerësimin e jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në terren;
- c. raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm,

VENDOS:

1. Akreditimin e plotë për kualifikimet profesionale:

- “Parukeri e avancuar” niveli V në KSHK
- “Estetikë e avancuar” niveli V në KSHK
- “Masazheri estetiko-kuruese” niveli V në KSHK
- “Fizioterapi estetike” niveli V në KSHK

Në përputhje me propozimin përkatës nr. 202/9, datë 2.12.2022 ardhur nga AKAFPK-ja (bashkëlidhur këtij urdhri):

1. Ofruesi i AFP-së t’i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik institucional sipas kësaj rregulloreje, çdo 4 vjet.

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendim, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

DELINA IBRAHIMAJ

